

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si kontestimore e përbër nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit ish-

me seli në Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson Agim Emini, kundër të paditurit Hasim Islami nga Mitrovica, Rr. “

„ baza e kontestit: lirimi i paluajtshmërisë, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datën: 07.05.2018 nxjerr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe **OBLIGOHET** i padituri që paditësit në emër të fitimit të humbur, t`ia paguaj shumën prej 13,635.80 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### **A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të përfaqësuesit të tij, ka parashtruar padi kundër të paditurit me të cilën ka këkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin që t`ia liroj pronën e uzurpuar duke precizuar sa i përket fitimit të humbur t`ia paguaj paditësit shumën prej 13,635.80 euro, të gjitha me kamat ligjore.

Me Aktgjykimin C.nr. 187/2009 të datës 30.04.2013 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit sa i përket lirimit të paluajtshmërisë, ndërsa është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket pagesës së qirasë.

Me Aktvendimin Ac.nr. 1827/2013 të datës 06.09.2016 Gjykata e Apelit e ka prishur aktgjykimin e lartcekur, sa i përket pikës IV dhe I të dispozitivit dhe atë sa i përket refuzimit të pagesës së qirasë për shfrytëzimin e paluajtshmërisë së paditësit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 26.02.2018 dhe fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke këkuar që të obligohet i padituri që në emër të fitimit të humbur t`ia paguaj paditësit shumën prej 13,638.80 euro me kamat. Shpenzimet nuk i kërkoi.

I padituri në seancën kryesore dhe fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe atë shumën e cekur për pagesë, si të pa përballueshme për standartin tim dhe i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet nuk i kërkoi.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e këtyre provave: procesverbali për ofrimin e kontratës për qiranë i datës 24.09.2009; Urdhëresa e datës 22.09.2009; Kontrata mbi caktimin e qirasë e datës 18.09.2009; Urdhëresa për lirimin e pronës 10.07.2009; Ftesa e datës 26.05.2009; Certifikata mbi të drejtat e pronës me nr. UL- të datës 16.03.2009; Fotografitë e bëra nga aeroinçizimi; Kontrata -- marrëveshja ndërmjet e dhe e datës 08.02.1987; Gjendja e njëhësorit elektrik të përpiluar nga elektro-kosmet në vitin 1997; dhe Ekspertiza financiare e datës 22.12.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Për gjykatën nuk është kontestuese fakti se paditësi është pronar i pronës në fjalë e cila vërtetohet nga Certifikata e pronësisë.

Nuk është kontestuese se i padituri banon në atë vend, pasi që një gjë të tillë e pranon edhe vet i padituri. Kjo vërtetohet edhe nga provat e tjera të dorëzuara nga ana e të paditurit.

Nuk është kontestues fakti se paditësi ka ndërmarrë veprime të caktuara për ta rastrojtur pronën e tij, kjo më së miri vërtetohet nga urdhëresat për lirimin e pronës të cilat paditësi ia ka dërguar të paditurit.

Gjykata vlerësoi se i padituri e ka shfrytëzuar në mënyrë permanente pronën që është objekt i kësaj padie, duke mos kompensuar në asnjë mënyrë paditësin – pronarin juridik për shfrytëzimin e saj. Këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të provave të cekura më lartë dhe se nuk ishte kontestuese as në mes palëve.

E drejta e paditësit gjen mbështetje në nenin 189 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (tutje: LMD), ku thuhet: "I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar". E që në rastin konkret gjykata ka konsideruar se paditësi e gëzon të drejtën në realizimin e fitimit të humbur për faktin se i padituri që nga muaji tetor i viti 2009 e tutje e ka shfrytëzuar pronën e paditësit pa kompensim dhe në këtë mënyrë ia ka pamundësuar paditësit të drejtën e shfrytëzimit apo edhe disponimit të lirë me këtë paluajtshmëri, e që rrjedhimisht do të realizonete fitim nga kjo pronë.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në paragrafin 3 të nenit 189 të LMD, ku përcaktohet se: "Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi". Në harmoni logjike me këtë dispozitë është edhe ekspertiza financiare e datës 22.12.2017, e cila ekspertiz në pikpamje të përmbajtjes nuk është kundërshtuar nga palët dhe të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi konsideroi se e njëjta është hartuar mbi bazën e parametrave adekuat në të gjitha aspektet, mbi bazën e ekzaminimit të dokumentave në shkresat e lëndës dhe në përputhje të plotë me Ligjin.

Gjykata i vlerësoi edhe provat e tjera por të njëjtat konsideroi se nuk janë të rëndësishme për çështjen.

Gjykata, lidhur me vendosjen për shpenzimet e procedurës, u bazua në nenin 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra palë nuk i kërkoi ato.

Gjykata aktgjykimin e mori duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C. Nr.553/2016 Datë:07.05.2018**

**GJYQTARI**  
**Faton Ademi**



**Këshilli juridike:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në afat 15 ditor nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.